

BULETINI

**kostt**



- ▶ Transmisioni përballë sfidave të zhvillimeve
- ▶ KOSTT zhvillon takim me Operatorin e Sistemit të shtetit të New York-ut
- ▶ KOSTT sh.a-Kompania e parë publike në vend që certifikohet me Standardin ISO 9001:2008
- ▶ Prezantohet Studimi për Zgjerimin e Rrjetit të Transmisionit të Republikës së Kosovës

## Përmbajtja

- |  |    |
|--|----|
| ▶ Transmisioni përballë sfidave të zhvillimeve   | 3  |
| ▶ KOSTT zhvillon takim me Operatorin e Sistemit të shtetit të New York-ut  | 5  |
| ▶ KOSTT sh.a-Kompania e parë publike në vend që certifikohet me Standardin ISO 9001:2008   | 6  |
| ▶ KOSTT dhe KESH nënshkruajnë Marrëveshjen për Shërbime Ndihmëse   | 6  |
| ▶ Instalohet Autotransformatori i ri në NS 220/110 kV Prishtina 4  | 6  |
| ▶ KOSTT siguron në përkushtimin maksimal në implementimin e suksesshëm të projektit të Autostradës Energjetike Kosovë-Shqipëri           | 7  |
| ▶ Sekretariati i Komunitetit të Energjisë thekson rolin e KOSTT në kooperimin rajonal si Operator i Sistemit të Transmisionit të Kosovës | 7  |
| ▶ Diskutohen çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlidhëse            | 8  |
| ▶ Matjet e rrjedhave të energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit të Kosovës  | 9  |
| ▶ Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë   | 9  |
| ▶ Prezantohet Studimi për Zgjerimin e Rrjetit të Transmisionit të Republikës së Kosovës  | 10 |
| ▶ Angazhimet e vazhdueshme të menaxhmentit të KOSTT në zgjidhjen e kontestit me Serbinë fillojnë të japin rezultate                      | 11 |
| ▶ Diskutohen çështjet ambientale të Linjës së Interkoneksionit 400 kV Kosovë-Shqipëri  | 12 |

Buletini është publikim i KOSTT sh.a,  
Rr. Iljaz Kodra p.n, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381(0) 38 501 601 174 ; email: info@kostt.com  
Web: www.kostt.com

Për më shumë informata rreth Buletinit, ju lutem kontaktoni:  
Zana Bajrami-Rama, menaxhere për komunikim  
zana.rama@kostt.com ose info@kostt.com

## Transmisioni përballë sfidave të zhvillimeve

**N**dër vitet më të rëndësishme në zhvillimit të Transmisionit për nga aspekti i rritjes së kapaciteteve transmetuese në Transmision, është viti 2009. Ky vit konsiderohet rumbullakim i targetit të vendosur tri vite më herët, atëherë kur mendohej se si duhet të dukej operatori i sistemit transmetues në kushte normale. Të arriturat e rëndësishme janë të shumta por mund të theksohen si në vijim: zvogëlimi i fyteve të ngushta, Sistemi i transmisionit për herë të parë arrin ti transmetoj 1170 MW në kohën e pikut, realizimi i projekteve voluminoze të prioritetit të lartë, aftësia e menaxhimit të projekteve kapitale në kohën e planifikuar, realizimi i planit të mirëmbajtjes mbi 90 %, menaxhimi me sukses i të gjitha planeve operative dhe projekteve nga operimi i sistemit, zbatimi i metodës së optimizimit të sistemit, zvogëlimi i humbjeve transmetuese përmes menaxhimit të energjisë dhe leximin e saktë të energjisë, vazhdimi i zhvillimit të kuadrove si një prej faktorëve kyç, avancimi i performansave të sistemit përmes faktorëve të matjes së performansave etj.

Megjithatë, e gjithë kjo ka qenë një sfidë e madhe e kaluar me sukses nga një mobilizim i stafit në KOSTT. Tani kur është krijuar një masë e konsiderueshme e mundësisë së sistemit për operim me besueshmëri më të lartë do të mund të flasim për performancën e sistemit.

Do të përshkruajmë momente të rëndësishme që lidhen me performancën e sistemit në të kaluarën dhe gjendjen e tanishme, si dhe të ardhmen përkatësisht zhvillimet që priten të ndodhin në sistemet elektroenergetike në Europë.

### a. Besueshmëria dhe Disponueshmëria e sistemit:

Operimi i suksesshëm i sistemit elektroenergetik varet kryesisht nga shërbime të besueshme dhe të sigurta duke i shërbyer furnizimit të ngarkesës pa ndërprerje.

Sistemi elektroenergetik definohet si kompleks që integron burime të ndryshme gjeneruese që mundësojnë të japin energji një numri të konsumatorëve me kërkesa të ndryshme.

Për të realizuar këtë qëllim sistemi dizajnohet që të ketë: Besueshmëri dhe Disponueshmëri të lartë

Besueshmëria e sistemit elektroenergetik përkufizohet nga këta faktorë:

- Kapaciteti i gjenerimit duhet të jetë më i madh se ngarkesa e sistemit
- Sistemi Transmetues përkatësisht elementet e sistemit në çfarëdo regjimi nuk duhet të mbingarkohen
- Tensionet duhet të jenë në kufijtë e lejuar me norma teknike
- Sistemi duhet të jetë në gjendje të mos bie në zero nëse ndodh humbja momentale e gjeneratorit
- Sistemi nuk duhet të humbë stabilitetin gjatë lidhjes së shkurtër (proceseve tranzitore)

Për vlerësimin e besueshmërisë atëhere dy komponente duhet të analizohen: Adekuacia dhe Siguria

**Adekuacia:** Aftësia e sistemit elektroenergetik bazuar në burimet gjeneruese të furnizoj konsumin gjatë tërë kohës duke marrë në konsiderim rënjet e planifikuara dhe të paplanifikuara të elementeve të sistemit.

**Siguria:** Aftësia e sistemit elektroenergetik që mbetet në operim pas një prishjeje në sistem siç janë lidhjet e shkurtëra, ose humbja e ndonjë elementi.

Sipas të gjitha analizave të bëra sistemi elektroenergetik në Kosovë ka pasur besueshmëri shumë të ulët. Shkalla e besueshmërisë së gjenerimit është dhe ka qenë e ulët. Nuk kemi adekuaci të gjenerimit dhe nuk pritet të kemi deri në ndërtimin e njesive të reja gjeneruese.

Në aspektin e transmisionit kemi pasur besueshmëri të ulët për shkak të mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme transmetuese në përputhje me konsumin dhe pajisje shumë të vjetra në operim. Besueshmëria e Transmisionit është rritur në mënyrë të theksueshme, mirepo për Furnizim të sigurt është e domosdoshme sigurimi i të gjitha shërbimet ndihmëse që aktualisht KOSTT nuk i ka. Megjithatë, pas investimeve të bëra në rrjetin transmetues performanca e sistemit dhe besueshmëria është ngritur në nivel të kenaqshëm që është norme standarde për operim normale të një kompanie të transmisionit.

Venja në Operim e projekteve si Peja 3, Kosova A dhe disa projekte tjera kanë kontribuar shumë në ngritjen e besueshmërisë së sistemit.

Rritja e besueshmërisë së sistemit është verifikuar dukshëm në dimrin e vitit 2010. Performancat teknike të sistemit të vlerësuara vazhdimisht japin indikacione për përmirësimin e besueshmërisë në sistemin transmetues të Kosovës.

Shih të dhënat për vitet 1999 - 2009.



Kadri Kadriu




Fig1. Rënjet mesatare të linjave nga viti 1999-2009





Fig2. Rënjet mesatare të Transformatorëve 1999-2009

Disponueshmëria e sistemit nuk ka qenë në kuader kritereve të operimit të mirë të një TSO. Rritja e konsumit në mënyrë të vazhdueshme deri në vlerën rreth 7% në vite kanë venë në pikëpyetje shkallën e disponueshmërisë së sistemit. Në këtë drejtim KOSTT ka ndjekur dhe do të vazhdojë të zhvillojë kapacitetet transmetuese duke mbajtur gjithmonë një margjinë të kapacitetit transmetues më të lartë se konsumi si dhe bazuar edhe në kriterin e sigurisë N-1. Në vitin 2007/2008 sipas kriterit N-1 kapaciteti i rrjetës transmetuese ka qenë 650MW ose rreth 30% më e ulët se kërkesa e pikut. Ky faktor tregon një disponueshmëri shumë të ulët të rrjetës transmetuese. Disponueshmëria e sistemit është rritur dhe sot konsiderohet që sipas kriterit N rrjeta transmetuese në Kosovë mund të bartë 1200MW.



### b. Sfidat e ardhshme dhe zhvillimi i sistemit transmetues:

Në vijim po i cekim disa sfida që janë në planin afatshkurtër në sistemin transmetues dhe që do të kenë ndikime afatgjatë në sektorin energjetik;


1. Sistemi elektroenergetik në Kosovë është duke kaluar në sfidat më të rëndësishme në historinë e zhvillimit të vet. Reforma në sektorin energjetik e filluar nga Qeveria e Kosovës si vazhdimësi e zhvillimeve energjetike që po ndodhin në Europë si duket në këtë vit do të jap sinjalet e para. Mundësia e fillimit të projektit për gjenerim Kosova e Re dhe privatizimi i Distribucionit janë po ashtu pikat që do ta tangojnë edhe KOSTT-in në krijimin e një raporti të ri me investitorët e rinj. Në këtë drejtim krijimi i marrëdhënieve të reja qoftë në këtë vit apo në vitet në vijim do të jetë edhe një sfidë e re për KOSTT-in.
2. Momenti vendimtar i tregut të energjisë ku do të definohet se si do të funksionoj tregu i lirë i energjisë në Kosovë. Pra dizajni i tregut mbetet të shihet?
3. Pritet të fillojë vlerësimi i kushteve teknike të funksionimit të sistemit nga grupi teknik në ENTSO-E
4. Krijimi i kushteve për njesitë e reja gjeneruese për energji të ripërtërishme.

### c. Cila është e ardhmja e zhvillimit të sistemit?:

Parashikimet për rritjen e konsumit të energjisë në Europë, Amerikë, Kinë dhe vende të tjera janë dramatike. Nevoja për inovacione në drejtim të përdorimit eficient të energjisë ka filluar në vitin 2007 kur Komisioni Europian përmes "Integrated Energy and climate change package" ka vënë target që në Europë të arrihet eficientia 20/20/20 deri në vitin 2020. Paralel me këtë KE ka vënë paketën e tretë të masave ku i detyron shtetet anëtare, rregullatorët dhe operatorët e sistemit të transmisionit dhe Distribucionit për të nisur programet inovative para vitit 2020. Kjo do të jetë sfida në zhvillimet e dhjetë viteve të ardhshme. Kërkesa për zvogëlimin e CO2 dhe përdorimin e energjisë së ripërtërishme është duke u rritur

çdo ditë. I tërë ky numër kërkesash mjaft të fuqishme kërkon një zhvillim ndryshe nga ajo që tani ekziston dhe për momentin ka një përgjigje që njihet si smart grid teknologji.

Smart grid është një grumbull kompleks ku përfshihet: krijimi i infrastrukturës komunikuese me konsumatorin, njehsorët inteligjent që mundësojnë komunikim me konsumatorët në dy anët, rrjeta inteligjente e transmisionit dhe distribucionit, Sistemi i modernizuar kompjuterik do të ju mundësojë kompanive operuese që të menaxhojnë energjinë deri në çdo shtëpi dhe po ashtu duke i siguruar konsumatorit edhe kontroll më të madhë të energjisë në shfrytëzim. Konsumatori do të jetë aktiv dmth një sistemi aktiv nga gjenerimi, deri te konsumatori. Konsumatori përmes njehsorëve inteligjent do të këtë mundësi të zgjedhë mënyrën e shfrytëzimit të energjisë, të shfrytëzojë energjinë më të lirë përmes pajisjeve inteligjente. Transmisioni dhe Distribucioni do të shfrytëzojnë kapacitetet e tyre maksimale dhe ta optimizojnë operimin e tyre. Rritja e konsiderueshme gjenerimin në nivelin e distribuimit ka bërë që të behet një presion i madhë në kompanit e distribuimit për të plotësuar kërkesat e reja. Kjo kërkon të rishikohet koncepti dizajnit të rrjetës distributive dhe investime të reja në rrjetën egzistuese.



Paralel me smart grid rritet mundësia e decentralizimit të operimit të sistemit e kjo kërkon një qasje të re edhe në planifikim të sistemit në krahasim me sistemet e centralizuara të projektuara më se 50 vite. Smart grid është teknologji mjaft e kushtueshme por e domosdoshme. Benefitet do të jenë të larta që lidhen me eficienten e energjisë dhe zvogëlimin e kostos. Vlen të theksohet se në vitin 2007 NERC në SHBA nënshkruan fillimin e zhvillimit të smart grid në SHBA. Danimarka ka bërë decentralizimin e prodhimit dhe sistemit të enegjise duke inkorporuar energjinë e erës për të plotësuar konsumin. Kina planifikon të kalojë në smart grid në vitin 2020. Në vitin 2010 Kolorado do të jetë vendi i parë në SHBA që do të ketë në funksion të plotë smart grid, pronarët do të monitorojnë sa energji do të marrin dhe prodhojnë në rrjetin elektrik përmes paneleve të tyre solare.

Tani në keto rrethna shtrohet pyetja Si do të operohet dhe zhvillohet sistemi transmetues dhe distributiv?

Ende ka shumë zhvillime që priten të shihen si do të funksionoj një sistem i tillë. Edhe me faktin se energjia pritet të shfrytëzohet në mënyrë shumë më eficiente, konsumi parashikohet të rritet dhe në fakt është ende indikative nevoja për ndërtime të kapaciteteve transmetuese.

(Kadri Kadriu)

## KOSTT zhvillon takim me Operatorin e Sistemit të shtetit të New York-ut

**D**elegacioni i KOSTT në përbërje të Kryeshefit Ekzekutiv z.Fadil Ismajli, Kryetarit të Bordit të Drejtorëve z.Ramadan Paqarada dhe Menaxheres për komunikim znj.Zana Bajrami-Rama, gjatë vizitës disa ditëshe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës zhvilluan takim me

e Sistemit të New York-ut në mesin e shumë vendeve të botës përfshirë vendet e rajonit të Evropës Jug-lindore.

**Prezentimi i Kryeshefit Ekzekutiv të KOSTT z.Ismajli zgjoi interesim në Forumin për Investime në New York**

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli gjatë vizitës në SHBA gjithashtu përcjelli punimet e Forumit të parë për Tregti dhe Investime organizuar nga Ambasada e Republikës së Kosovës në Washington dhe Developing Markets Associates. Prezentimi i z.Ismajli në kuadër të Sesionit për Energji të



Operatorin e Sistemit të shtetit të New York-New York Independent System Operator (NYISO), përkatesisht me zv.Presidentin për Operim z.Richard Dewey si dhe Specialistin për Komunikim z.Keneth Klapp. Kompanitë homologe me këtë rast shkëmbyen përvojat si dhe diskutuan për shumë çështje të interesit të përbashkët. Delegacioni i KOSTT u njoh për së afërmi me funksionimin e sistemit energjetik në SHBA, sistem mjaft kompleks me mbi 300 gjenerues të energjisë elektrike ku burimet e energjisë janë të shumëllojshme duke filluar nga era, uji, gazi, energjia nukleare etj, si dhe vizitoi Qendrën Nacionale Dispeçerike të New Yorkut me bazë në Albany. Delegacioni i Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Republikës së Kosovës ishte vendi i 63-të që vizitoi Operatorin



Forumit, zgjoi interesim nga ana e pjesëmarrësve, të cilët KOSTT-in e cilësuan si një Storie të Suksesshme nga ana e të arriturave si dhe menaxhimit.

Përveq investitorëve potencial që ishin pjesëmarrës në këtë Forum, gjithashtu të pranishëm ishin edhe përfaqësuesja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në OKB znj.Rosemary Di Carlo, kongresmeni amerikan z.Eliot Engel, drejtoresha e Bankës Botërore për EJJ znj.Jane Armitage si dhe përfaqësues të Qeverisë së Kosovës si dhe institucioneve të tjera me interes nga vendi.



## KOSTT sh.a-Kompania e parë publike në vend që certifikohet me Standardin ISO 9001:2008

**P**as një angazhimi të përgjithshëm për vendosjen dhe zbatimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a u certifikua me Standardin ISO 9001:2008, nga kompania prestigjioze globale Bureau Veritas me seli në Paris.

Pas auditimit të jashtëm të sistemit të menaxhimit të organizatës nga ana e Bureau Veritas, është vërtetuar konformiteti me kërkesat e Standardit dhe me këtë KOSTT sh.a bëhet kompania e parë publike në Kosovë e cila certifikohet me Standardin ISO 9001:2008.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli, me këtë rast theksoi “Kjo e arritur e KOSTT, dëshmon që fokusi ynë qëndron në menaxhimin kualitativ dhe performansë të standardeve ndërkombëtare, por gjithnjë duke qenë të vendosur që në mënyrë të vazhdueshme të përcjellim dhe plotësojmë të priturat nga ana e klientëve apo palëve tona të interesit dhe punonjësve të kompanisë”.

Procesi i organizimit të punës në KOSTT në përputhje me standardin ISO 9001:2008 ka filluar dukshëm më herët, ndërkaq puna intensive me angazhimin e të gjithë punonjësve për vendosjen dhe zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë në kompani ka filluar në vitin e kaluar. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe një ekip i punonjësve të KOSTT janë trajnuar dhe certifikuar për auditorë të brendshëm për ISO 9001:2008, nga kompania vendore dce.



### KOSTT dhe KESH nënshkruajnë Marrëveshjen për Shërbime Ndhimëse

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) dhe Korporata Energjetike e Shqipërisë (KESH), me 1 mars 2010, në Prishtinë, nënshkruan Marrëveshjen për Shërbime Ndhimëse. Marrëveshja për Shërbime Ndhimëse e cila u nënshkrua nga Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli dhe Drejtori Menaxhues i KESH z.Muharrem Stojku, parasheh blerjen e shërbimeve ndihmëse në rregullimin frekuencë-fuqi, nga gjeneratorët e KESH respektivisht nga gjeneratorët e Hidrocentralit të Fierzës.

Pas nënshkrimit të kësaj marrëveshje bilaterale, KOSTT në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Shqipërisë-OST, do ti ndërmarr të gjitha masat e vendosjes së infrastrukturës së nevojshme në mënyrë që këto shërbime të jenë në funksion të operimit të sistemit elektrik të Kosovës.

Marrëveshja është plotësisht në harmoni me standardet Evropiane respektivisht të Asociacionit të Operatorëve Evropian të Sistemit të Transmisionit për Energji Elektrike ENTSO-E.

### Instalohet Autotransformatori i ri në NS 220/110 kV Prishtina 4

Në përputhje me Planin Zhvillimor të Sistemit të Transmisionit të Kosovës 2007-2013 në korrik të vitit 2010 u instalua Autotransformatori i ri AT3 me fuqi 150 MVA (mega volt amper) në Nënstacionin Prishtina 4.

Ky projekt në vlerë prej 2.845.000 Euro u financua nga buxheti i KOSTT për investime kapitale. Me instalimin e autotransformatorit të ri në NS Prishtina 4 do të eliminohen fytyt e ngushta në transformim të energjisë elektrike në këtë nënstacion, do të rritet siguria dhe besueshmëria e sistemit transmetues, plotësohet kriteri N-1 dhe do të mundësohet zgjerimi i mëtejshëm i rrjetit transmetues.



## KOSTT siguron në përkushtimin maksimal në implementimin e suksesshëm të projektit të Autostradës Energjetike Kosovë-Shqipëri

**P**arlamenti i Republikës së Kosovës me shumicë absolute të votave me 1 prill të vitit 2010 ratifikoi Marrëveshjen për Kredi dhe Financim të linjës interkonektive 400kV, Kosovë-Shqipëri.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli, ka falënderuar Parlamentin e Republikës së Kosovës për mbështetjen që i dhanë këtij projekti madhorë, duke theksuar “ju siguroj në përkushtimin maksimal të KOSTT për implementim të suksesshëm të projektit të ndërtimit të linjës interkonektive 400 kV, Kosovë-Shqipëri". Marrëveshja parasheh një buxhet prej €33,5 nga e cila €17,0 mil është kredi komerciale afatgjate me kushte kredituese të buta dhe €16,5 mil grant të Qeverisë Gjermane.

Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës (KOSTT) së bashku me Operatorin e Sistemit të Transmisionit të Republikës së Shqipërisë-OST janë duke punuar intensivisht deri në finalizimin e këtij projekti.

Projekti në fjalë paraqet interkoneksion të rëndësishëm jo vetëm për Kosovën dhe Shqipërinë por edhe për rajonin.



Me ndërtimin e linjës së re 400 kV Kosovë-Shqipëri do të rriten mundësitë e shkëmbimit më të madhë të energjisë elektrike në mes të dy vendeve. Aktualisht, Kosova dhe Shqipëria janë të lidhura me një linjë interkonektive 220 kV.

## Sekretariati i Komunitetit të Energjisë thekson rolin e KOSTT në kooperimin rajonal si Operator i Sistemit të Transmisionit të Kosovës

Një delegacion nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë (SKE) i kryesuar nga drejtori Slavtcho Neykov realizuan një vizitë në KOSTT në muajin korrik 2010 me ç'rast realizuan një takim me Kryeshefin Ekzekutiv z.Fadil Ismajli dhe bashkëpunëtorët e tij.

Në takim u bisedua rreth progresit të ankesës që ka dorëzuar KOSTT, të paraparë si e drejtë që rrjedh nga Kapitulli i VII i Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore, në SKE në gusht të vitit 2008, ndaj Republikës së Serbisë si palë e Komunitetit të Energjisë. Republika e Serbisë respektivisht Operatori i saj i Transmisionit refuzon të transferoj të hyrat e kolektuara në emër të energjisë elektrike të transituar nëpër rrjetin e Kosovës si dhe të hyrat nga ndarja e së drejtës së shfrytëzimit të kapaciteteve të interkoneksionit të Kosovës

tregtuesve të energjisë elektrike duke shkaktuar dëme materiale Kosovës që nga 01 Korriku 2004 dhe duke shkelur provizionet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore. Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Ismajli potencoi përkushtimin e vazhdueshëm të KOSTT për zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështjeje. Gjithashtu z.Neykov u njoftua me përgatitjet intenzive që po i zhvillon KOSTT në përmbushjen e kriterëve për anëtarësim në ENTSO-E si asociacion i vetëm i OST-ve të Evropës ku koordinohen dhe rregullohen marrëdhëniet e operimit në sinkron të OST-ve.

Drejtori i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë z.Neykov duke theksuar rolin e rëndësishëm që kanë Operatorët e Sistemit të Transmisionit (OST) sidomos duke u bazuar në Pakon e 3-të të legjislacionit për energjinë elektrike të Bashkimit Evropian, potencoi rolin e KOSTT si shumë të rëndësishëm në zhvillimet e tregut të energjisë elektrike në nivel vendor dhe të kooperimit rajonal, si OST e Kosovës.

## Diskutohen çështjet ambientale të Linjës së Interkoneksionit 400 kV Kosovë-Shqipëri

**M**e organizimin e përbashkët të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH) dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT, me 19 prill 2010, në Gjakovë u mbajt Debat Publik rreth çështjeve ambientale të linjës interkonektive 400 kV (kilovolt) Kosovë-Shqipëri. Në këtë takim u prezantua Raporti i vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) të linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri me ç'rast qytetarët dhe palët e interesuara patën rastin që të drejtojnë pyetjet e tyre rreth çështjeve ambientale panelit i cili ishte në përbërje të përfaqësuesve të KOSTT dhe të MMPH.

Shqipërisë vazhdon në territorin e Kosovës duke kaluar nëpër territoret e Komunave të Gjakovës, Junikut, Deçanit, Rahovecit, Drenasit, Malishevës, Vushtrrisë dhe Kastriotit.

Në këtë takim, zv.Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Naim Bejtullahu, foli rreth rëndësisë së këtij projekti duke theksuar se “ndërtimi i linjës 400 kV Kosovë-Shqipëri do të ndikojë në optimizmin e dy sistemeve elektroenergetike asaj të Kosovës ku gjenerimi i energjisë është i bazuar kryesisht në termo dhe asaj të Shqipërisë ku gjenerimi i energjisë është kryesisht i bazuar në hidro”.



Raporti i VNM-së për këtë projekt i cili është hartuar duke u bazuar në të gjitha ligjet ekzistuese në Kosovë që kanë të bëjnë me Energjinë dhe Mjedisin dhe duke ndjekur standardet e ligjeve të vendit dhe ato ndërkombëtare, ka pasur për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis si rezultat i këtij projekti.

Gjithashtu në këtë takim si pjesë e Raportit të VNM-së u prezantuan edhe kushtet mjedisore që duhet përmbushur gjatë ndërtimit të linjës 400 kV ku u prezantua edhe traseja e linjës e cila është nga Vau i Dejës që gjendet në territorin e

Në anën tjetër këshilltari i Ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Husnija Beshkoviq theksoi se “MMPH është e bindur që do të respektohen të gjitha procedurat dhe rregullat mjedisore gjatë implementimit të këtij projekti”.

Në përfundim të prezantimit të Raportit të VNM-së për linjës interkonektive 400 kV Kosovë-Shqipëri u konkludua se linja e planifikuar do të ketë një ndikim pozitiv në ekonominë e vendit si dhe do të sigurojë shkëmbim më të madhë të energjisë elektrike në mes të Kosovës dhe Shqipërisë sidomos me ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të planifikuara në të dy vendet.



## Matjet e rrjedhave të energjisë elektrike në rrjetin e transmisionit të Kosovës

**M**atja e rrjedhave të energjisë elektrike që kalon nëpër rrjetin e transmisionit të Kosovës, realizohet përmes grupeve matëse të instaluar në secilin nënstacion ku ekzistojnë kufijtë e matjes në mes të KOSTT sh. a. - dhe “palëve tjera” (TSO fqinjë, gjeneratorëve, DSO dhe konsumatorëve të kualifikuar /privileguar). Kufiri i matjes me “palët e tjera” është i precizuar në Kodin e Matjes.

Me qëllim që të gjitha matjet të jenë të vendosura në kufirin ndarës, KOSTT sh.a ka implementimin e Projektit “ITSMO Njehsorët”, projekt ky që ka përfshirë instalimin e grupeve të reja matëse (transformatorët matës, ormanët e matjeve me njehsorë, pastaj instalimin e Server-it dhe aplikacionit përkatës për grumbullimin e të dhënave në qendër, etj.). Ky projekt është implementuar në pikat matëse të rrjetit të transmisionit në nivelin e tensionit 110kV. Pas implementimit të këtij projekti, sistemi i matjeve në KOSTT sh. a., në pjesën më të madhe të saj mund të thuhet se është sistem, i cili është në pajtueshmëri të plotë me Kodin e Matjeve dhe i krahasueshëm me sistemet moderne të matjeve në Evropë.

Me përfundimin e këtij projekti, rreth 90-95% e njehsorëve aktualisht lexohen nga distanca përmes Qendrës për Grumbullimin e të Dhënave. Ndërsa, vetëm 5-10% e njehsorëve, përkatësisht njehsorët të cilët gjenden nëpër daljet 35kV, 6,3kV dhe 0,4kV të Konsumatorëve të Privileguar (kryesisht në NewCo Ferronikeli, SharrCem, Trepça dhe TC Kosova A) ky operim nuk është e mundur.

Mbarëvajtja e matjeve nga Linjat e Interkoneksionit në mënyrë të

vazhdueshme realizohet me bashkëpunime rajonale të ndërsjellta. KOSTT sh. a. në periudha të rregullta kohore është në kontakt me palët homologe nga OST(Shqipëri), MEPSO(Maqedoni), si dhe me A. D. PRENOS(Mali i Zi), me të cilët të paktën një herë në muaj mban kontakte të rregullta me qëllim të këmbimit të të dhënave matëse të energjisë elektrike e cila rrjedh gjatë muajve përkatës nëpër këto Linja Interkonektive.

Përveç kësaj, nga aspekti i matjeve, KOSTT sh. a. realizon kontakte të rregullta bashkëpunimi me TSO-të fqinje, dhe atë çdo dy vite, me qëllim të shqyrtimit dhe testimit të njehsorëve në operim për Linjat Interkonektive në të dy anët e linjës në përputhje me obligimet që dalin në batë të Rregulloreve të ENTSO (UCTE).

Ky bashkëpunim realizohet me qëllim që të bëhen verifikimet e nevojshme të klasave të saktësisë së matjes për njehsorët ekzistues, që të sigurohen të dyja palët që njehsorët në operim janë brenda kufijve të lejuar të saktësisë së matjes ashtu si e deklaroi prodhuesi, si dhe vlerat e fituara të jenë në harmoni me standardet e definuara ndërkombëtare.



Rexhep selimi

*(Rexhep Selimi)*

## Vendimet e Zyrës së Rregullatorit të Energjisë

**Z**yra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 29 dhjetor 2010 ka aprovuar Kodin për Stacionet Gjeneruese të Energjisë me Erë të dorëzuar nga Operatori i Sistemi të Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT Sh.a.) (V\_332\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 11 nëntor 2010, ka aprovuar “Standardet e Kualitetit të Furnizimit dhe Shërbimit me Energji Elektrike për Operatorin e Sistemit të Transmisionit” të KOSTT Sh.a të cilat do të fillojnë të zbatohen nga data 1 janar 2011. (V\_318\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me datë 11 nëntor 2010, ka aprovuar Metodologjinë e Taksave për Kycje në Rrjetin e Transmisionit të KOSTT Sh.a (V\_316\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 11 nëntor 2010 ka lejuar derogimin e zbatimit të dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit dhe të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit (V\_315\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 shtator 2010, aprovoi dokumentin “Plani Zhvillimor i Transmisionit 2010 – 2019” (V\_293\_2010)



**ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI**  
**ENERGY REGULATORY OFFICE**  
**RËGULATORNI URED ZA ENERGIJU**

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 shtator 2010, aprovoi amendamentimet e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit sipas kërkesës së KOSTT sh.a të dorëzuar përmes KQKO (V\_292\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 10 shtator 2010, aprovoi amendamentimet e disa dispozitave të Kodit të Matjes, sipas kërkesës së KOSTT sh.a të dorëzuar përmes KQKO (V\_291\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 24 qershor 2010 ka aprovuar kërkesën e KOSTT sh.a për derogimin në zbatimin e dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes dhe Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, sipas kërkesës së KOSTT (V\_249\_2010)

Zyra e Rregullatorit të Energjisë në mbledhjen e Bordit të mbajtur me 24 mars 2010 ka aprovuar tarifrat dhe ngarkesat e transmisionit, për zbatim nga KOSTT SH.A. nga data 1 prill 2010 (V\_230\_2010)

## Prezantohet Studimi për Zgjerimin e Rrjetit të Transmisionit të Republikës së Kosovës

**O**peratori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a organizoi Tryezë Pune në shtator të vitit 2010 ku u prezantua Studimi për Zgjerimin e Rrjetit Transmetues të Republikës së Kosovës.


Objektivë kryesore e studimit “Zgjerimi i Rrjetit Transmetues” është ofrimi i udhëzimeve për modernizimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të Sistemit Elektroenergetik të Kosovës.

Zhvillimi i sektorit të energjisë elektrike në Kosovë në fazën e pasluftës është bazuar në studimin e Bankës Botërore ESTAP I, i cili me Master plan ka përfshirë edhe segmentin e zhvillimit të rrjetit të transmisionit në bazë të kornizave të të cilit KOSTT ka hartuar planet zhvillimore vetanake, të cilat kanë marrë në konsideratë zhvillimin e kërkesën për energji dhe fuqi, si dhe kriteret e sigurisë së operimit.

Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli duke folur për rëndësinë e planifikimit të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike, e posaçërisht të rrjetit të transmisionit, me këtë rast theksoi “Ristrukturimi i sektorit të energjisë elektrike në rajon dhe vend e së fundmi zhvillimet në ngritjen e kapaciteteve të reja elektroenergetike (Projekti Kosova e Re) në një anë dhe Privatizimi i Shpërndarjes dhe Furnizimit në anën tjetër shtruan nevojën për një studim të ri i cili do të përcaktoj



Këto investime kanë mundësuar rimëkëmbjen e sistemit dhe daljen nga gjendja emergjente për të vazhduar me fazën e zhvillimit, e cila ka rezultuar me efekte shumë pozitive sa i përket uljes së numrit të rënieve/prishjeve dhe ngritjes së besueshmërisë së sistemit dhe zvogëlimit të humbjeve të energjisë elektrike në transmision. Sipas z.Ismajli, “Gjendja aktuale e rrjetit është e mirë që do të thotë se në mënyrë të relaksuar akomodon ngarkesën, por ne nuk duhet dhe nuk do të ndalemi me kaq, kemi synim që në planin afatmesëm të



*Hartat e SEE aktuale dhe sipas Studimit*

drejtimit e zhvillimit të sistemit të transmisionit për vitet e ardhshme”. Studimi për “Zgjerimin e Rrjetit Transmetues” të Kosovës identifikon projekte të qarta dhe ofron rekomandime konkrete dhe konkluzë e përgjithshme është se topologjia e rrjetit të transmisionit gradualisht duhet të ndryshohet nga tipi “YLL” në atë “UNAZË”, zgjidhje që ofron fleksibilitet më të madh, në mënyrë që ngarkesa e konsumit dhe kapacitetet e reja gjeneruese të akomodohen në mënyrë të sigurtë dhe kualitative. Që nga themelimi i KOSTT në mes të vitit 2006 deri më tani në rrjetin e transmisionit të Kosovës janë investuar më shumë se 100 milion euro, në projekte për ngritjen e kapaciteteve transmetuese, ngritje të sigurisë, dhe për përkrahje të ngarkesës.

përmes kriteret shtesë të sigurisë, Kriterin N-1, dhe pastaj të vazhdojmë me implementimin e teknologjive bashkëkohore”. Financimin për realizimin e Studimit për “Zgjerimin e Rrjetit Transmetues” e ka bërë Qeveria Gjermane nëpërmjet Bankës Gjermane për Zhvillim KfW ndërkaq studimi është realizuar nga kompania konsulente gjermane FICHTNER. Në Tryezën e Punës ku u prezantua studimi për “Zgjerimin e Rrjetit Transmetues” të Republikës së Kosovës, ishin prezent të gjitha palët e interesit vendorë dhe ndërkombëtarë të sektorit të energjisë rekomandimet e të cilëve do të përfshihen në versionin përfundimtar të Studimit.

## Angazhimet e vazhdueshme të menaxhmentit të KOSTT në zgjidhjen e kontestit me Serbinë fillojnë të japin rezultate

**O**peratori i Transmisionit të Serbisë (EMS) me veprimet e saja jo të drejta po i shkakton dëme të mëdha financiare KOSTT-it dhe konsumatorëve të Kosovës në përgjithësi duke shkelur dispozitat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore. Duke u prezantuar si pronare, pa ndonjë bazë ligjore, e aseteve transmetuese të Kosovës, EMS përfiton nga transiti i energjisë elektrike nëpër Kosovë si dhe nga shitja e së drejtës së shfrytëzimit të linjave interkonektive (alokimi i kapaciteteve) dmth duke ndarë kapacitetet edhe për linjat tona të interkoneksionit me Malin e Zi, Maqedoninë dhe Shqipërinë tregtarëve të energjisë elektrike pa autorizim nga KOSTT. Në këtë mënyrë, Operatori i Transmisionit të Serbisë (EMS) përfiton rreth 2 Milion € në vit në emër të transimit nëpër rrjetin e KOSTT-it para e cila ishte dashur të i kthehej konsumatorëve, kurse nga alokimi i kapaciteteve interkonektive të Kosovës përfiton rreth 3 Milion € në vit



(gjithsej 5 milion € në vit në emër të KOSTT).

EMS e konsideron importin e Kosovës si import për konsumatorët e vet dhe tregtarët e energjisë elektrike janë të detyruar që të paguajnë TVSH në Serbi, vlerë e cila pastaj përfshihet në çmimin e importit në Kosovë. Në këtë mënyrë, ky operator shkakton edhe dëme indirekte në rritjen e çmimit të importit të energjisë në Kosovë, të cilat në fund barten nga konsumatorët e Kosovës e që sipas vlerësimeve arrijnë vlerën rreth €7- €10 milion (TVSH 19% në çmimin e energjisë). Në këtë kontekst, çmimet e importit të energjisë elektrike në Kosovë janë më të larta për rreth 20% në krahasim me vendet e tjera të rajonit.

Për zgjidhjen e kësaj çështjeje, menaxhmenti i KOSTT ka qenë i përkushtuar në ndërmarrjen e veprimeve të vazhdueshme për zgjidhjen e problemit me Serbinë, që nga themelimi në mes të vitit 2006, duke sensibilizuar institucionet relevante vendore dhe ndërkombëtare, nga asociacionet që merren me çështje teknike e deri te instancat më të larta të Komunitetit të Energjisë, si dhe të Komisionit Evropian. Dhe, tashmë këto angazhime kanë filluar të japin rezultate.

Pas ankesës formale që KOSTT ka dorëzuar në gusht të vitit 2008 në Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë në Vjenë (SKE), në fund të shtatorit të vitit 2010 SKE ka hapur procedurën e kontestit ndaj Serbisë për shkelje të dispozitave të Traktatit. SKE e ka konsideruar valide ankesën e KOSTT me konsiderimin preliminar që EMS ka dështuar të përmbushë obligimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë.

Rasti tani është duke u përcjellur sipas procedurave ligjore të SKE, dhe Kryeshefi Ekzekutiv i KOSTT z.Fadil Ismajli në lidhje me rastin shprehet “Jam i bindur se përfundimisht çështja në mes të KOSTT dhe operatorit të Serbisë do të zgjidhet, dhe unë pres që në të ardhmen bashkëpunimi me EMS të jetë sikurse edhe me çdo TSO (Operator të Sistemit të Transmisionit) të vendeve të tjera të rajonit dhe më gjerë”.

Sistemi i transmisionit të Republikës së Kosovës paraqet një nyje të rëndësishme rajonale prandaj çdo veprim radikal do të rrezikonte sigurinë dhe stabilitetin e sistemit rajonal të energjisë elektrike, derisa siguria dhe stabiliteti i Sistemit të energjisë elektrike është një nga kërkesat kryesore të Traktatit të Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore si dhe nga politikat e ENTSO-E që është në nivel Evropian.

Kosova është anëtare e Komunitetit të Energjisë për Evropën Juglindore dhe është duke punuar intensivisht për anëtarësimin në ENTSO-e dhe rrjedhimisht, menaxhmenti i KOSTT ka zgjedhur rrugën ligjore për sensibilizimin dhe trajtimin e çështjes.

## Diskutohen çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlidhëse

**N**ën organizimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës-KOSTT sh.a dhe Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në tetor 2010 u mbajt Debat Publik për çështjet ambientale të projektit për ndërtimin e Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlidhëse 400 kV dhe 110 kV (kilovolt). Në Debatin Publik në të cilin ishin të ftuar qytetarët dhe përfaqësuesit e institucioneve qendrore dhe të komunave të Ferizajt, Gjilanit dhe Vitisë, u prezantua Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) të Paket Projektit Ferizaj 2, me ç'rast të pranishmit patën rastin që të shtrojnë pyetje për çështje me interes në lidhje me projektin. Raporti i VNM-së për këtë projekt i cili është hartuar duke u bazuar në të gjitha ligjet ekzistuese në Kosovë që kanë të bëjnë me Energjinë dhe Mjedisin dhe duke ndjekur standardet e ligjeve të vendit dhe ato ndërkombëtare, ka pasur për qëllim identifikimin dhe parashikimin e ndikimeve të mundshme në mjedis si rezultat i këtij projekti. Sipas raportit të VNM-së gjatë implementimit të Paket Projektit Ferizaj 2 do të zbatohen të gjitha masat mbrojtëse të rekomanduara në këtë studim, prandaj ndërtimi i Nënstacionit të ri 400/110 kV Ferizaj 2 dhe linjave ndërlidhëse nuk ka potencial për rrezikim të shëndetit të njeriut dhe mjedisit. Ndërtimi i shtyllave elektrike sipas projektit është paraparë të bëhet me rregulla të pranueshme, në distanca të pranueshme nga shtëpitë dhe rruga dhe posedon pjesët ndihmëse mbrojtëse të cilat zvogëlojnë rrezikun nga aksidentet. Drejtori për menaxhim të projekteve dhe Inxhinieri në KOSTT z.Illir Shala, duke folur për rëndësinë e këtij projekti theksoi “Paket Projekti Ferizaj 2 është projekt tejet i rëndësishëm për përmirësimin e besueshmërisë, kualitetit, sigurisë dhe efijencës së Sistemit Elektroenergjetik të Kosovës dhe kjo bazohet në faktin se me kompletimin e këtij projekti do të rriten



kapacitetet transmetuese të Rrjetit të Transmisionit, duke eliminuar një numër të madh të fyteve të ngushta, do të reduktohen në masë të madhe humbjet teknike në rrjet, do të përmirësohet profili i tensionit, i cili reflekton në kualitet të lartë të furnizimit, do të rritet siguria dhe besueshmëria e operimit të Rrjetit Transmetues dhe rrjedhimisht mundësohet përkrahja e zhvillimit të gjithëmbarshëm ekonomik të rajonit të Kosovës Jug-Lindore e më gjerë”. Paket Projekti Ferizaj 2 është projekti i KOSTT sh.a (Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të energjisë elektrike të Kosovës) dhe bashkë-financohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Komisionit Evropian. PP Ferizaj 2 përmban ndërtimin e nënstationit NS 400/110 kV – Ferizaj 2 dhe ndërtimin e linjave ndërlidhëse 400 kV dhe 110 kV, që lidhin këtë nënstation në anën 400 kV me NS Kosova B dhe NS Shkupi 5, kurse në anën 110 kV me NS Bibaj, NS Sharr, NS Kosova A dhe NS Gjilani 5. Ndërtimi i Nënstacionit Ferizaj 2 bashkë me linjat përcjellëse do të kalojnë nëpër territoret e Komunave të Ferizajt, Vitisë dhe Gjilanit.

